1. IPET në shfrytëzim afatëshkurtër pa kompenzim në periudhën prej 15 viteve, Prona e Paluajtshme Komunale, pjesë e ndërtesës së Shtëpisë së Kulturës "Isa Kastrati" organizatës joqeveritare-Fondacionit "Bone Vet Kamenicë", duke pasur parasysh arsyet dhe interesin publik komunal.
2. Prona e cila ipet në shfrytëzim është e regjistruar në Çertifikatën Pronësore nr.02-670/2019 d.t. 26.12.2019, P-71107041-01553-0-35-0, vendi i quajtur "Lumi" në Kamenicë, ana jugore e ndërtesës, kati P-pjesë nga hapësira mbrenda Ndërtesës-Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati" Kamenicë, me sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup>, si dhe bodrumi nga e njehta ndërtesë me sipërfaqe 66 m<sup>2</sup>, e cila në Zyrën Komunale Kadastrale evidencohet në emër të P.SH.Kuvendi Komunal Kamenicë, për Z.K.Kamenicë.
3. Fondacioni Bone Vet Kamenicë, Çertifikata e Regjistrimit Nr.5200497-7 ka lidhur Marrëveshjen Sh.02. nr. 29301 dt. 19.11.2019 mes partnerëve themelues nga njëra anë, dhe Komunës së Kamenicës përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Qëndron Kastrati, për krijimin e kushteve për të rinjtë dhe qytetarët e komunës së Kamenicës që të trajtohen në profesione të ndryshme përmes njohurive teorike dhe praktike të teknologjisë moderne, të cilat janë burim potencial i ideve inovative për krijimin e bizneseve të sukseshme.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesët Kryetari i Komunës, ku do të e nënshkruaj kontratën mbi të drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm në mes të shfrytëzuesit -Fondacioni"Bone Vet Kamenicë" nga njëra anë dhe Kryetarit të Komunës nga ana tjetër, kurse Kontratën do të e hartoi DPKGJ-ja-Sektori i Pronës.
5. Vendimit i bashkangjiten: Marrëveshja për themelimin e "Fondacionit BONEVET Kamenicë" SH.02,Nr.29301/19.09.2019; Koncepti për Kamenicën; Letërkonfirmimi me Ref.414/2020.
- 6.Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me vendimin të njoftohen: Kryetari i Komunës; Kryesuesi i Kuvendit; MAPL-ja; Zyra e Përkthimeve dhe QShQK-ja







Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Municipality of Kamenica

Në bazë të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 7 par.3 të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në pajtim me nenin 1 të Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës drejt përmbushjes së interesit të përgjithshëm publik, pas marrjes së kërkesës- koncepti të dërguar nga Fondacioni UNE E DU KOSOVEN, për hapjen e Fondacionit BONEVET Kamenicë të datës 16.08.2019, për marrjen e pronës komunale në shfrytëzim nga OJQ "Fondacioni BONEVET Kamenicë", Marrëveshjes për Themelimin e Fondacionit "Fondacioni BONEVET Kamenica" SH.02 Nr. 29301 të datës 19.09.2019, Kryetari i Komunës në cilësinë e Pranuesit të Ofertës, dhe Fondacioni BONEVET Kamenica me certifikatë të regjistrimit nr. 5200497-7 në cilësinë e ofertuesit, pas zhvillimit të negociatave kanë arritur këtë:

#### PRANIM OFERTE

Si për pikat më poshtë:

1. Komuna e Kamenicës jep në shfrytëzim 466m<sup>2</sup> të hapësirës publike pa kompensim.
2. Afati i dhënies me qira të hapësirës publike është pesëmbëdhjetë (15) vite.
3. OJQ "Fondacioni BONEVET Prishtina" dhe OJQ "Fondacioni UNE E DU KOSOVEN" do të asistojnë OJQ "Fondacioni BONEVET Kamenicë" në sigurimin e mjeteve financiare në vlerë prej 145,000.00 euro në investime për ushtrimin e funksionit e kësaj qendre në hapësirën e lëshuar me qira nga Komuna e Kamenicës. Me konkretisht OJQ "Fondacioni BONEVET Prishtina" dhe OJQ "Fondacioni UNE E DU KOSOVEN" do të kontaktojnë donatorët të cilët kanë përkrahur themelimin e qendrave BONEVET në Gjakovë, Prishtinë dhe Kaçanik që të mbështesin edhe këtë qendër në Kamenicë  
Për të arritur këtë shume të investimeve, OJQ si motër Fondacioni BONEVET Prishtinë, ka siguruar një donacion me pajisje teknologjike në vlerë prej 73,000.00 Euro të cilat janë të destinuara si donacion për OJQ "Fondacioni BONEVET Kamenicë", pajisje këto të cilat i ka në pronësi dhe i janë dhuruar nga GIZ në Kosovë pikërisht për themelimin e qendrës BONEVET Kamenica.
4. Kontrata me kushtet specifike për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim për personin juridik – OJQ "Fondacioni BONEVET Kamenicë" do të përpilohet dhe nënshkruhet nga palët pas aprovimit të Propozimit të Kryetarit në Kuvend, dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga ana e institucionit qendror përkatës.

19.09.2019

Kamenicë



Qendron Rastrati – Kryetar i Komunës

Lekë Zherka – Koordinator  
OJQ "Fondacioni BONEVET Kamenicë"

BONEVET është hapësirë krijuese ku fëmijët nxitën që të zbulojnë talentet dhe aftësitë e tyre dhe t'i zhvillojnë ato me pasion dhe dashuri. BONEVET është një institucion arsimor jofitimprurës dhe joformal i themeluar në vitin 2014 nga fondacioni privat UNË E DU KOSOVËN me seli në Prishtinë.

BONEVET është dizajnuar për të stimuluar kuriozitetin, imagjinatën dhe kreativitetin e fëmijëve. Fëmijët inkurajohen që të mësojnë përmes lojës dhe teknologjisë, të krijojnë lojërat e veta, të programojnë robotë, të bëjnë prototipa me 3D printer, të punojnë së bashku me fëmijët e tjerë, të zgjidhin gjëgjëza dhe mistere të ndryshme, të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit, të lexojnë libra dhe të mësojnë gjuhë të huaja.

Mendja e fëmijës është makina më e fuqishme e mësimi që njohim. Çdo fëmijë lind me aftësi natyrore. Fëmijët kanë kapacitete të mëdha për të mësuar. Ata posedojnë aftësi të pavarura të të mësuarit, e duan të mësuarit dhe truri i tyre rritet gjersa përpjekën dhe bëjnë dështime.

Por, studimet e kohëve të fundit kanë ofruar dëshmi se pavarësisht nga kapacitetet natyrore që i posedojnë, është mjedisi dhe kultura në të cilën rriten fëmijët, ajo që ka një ndikim të thellë në zhvillimin e tyre.

Në BONEVET të gjitha vajzat dhe djemtë inkurajohen të jenë kureshtarë, të përdorin imagjinatën e tyre dhe të jenë krijues. Koncepti BONEVET bazohet në të mësuarit individual, punës praktike të bazuar në mësim, të cilat përfundimisht dërgojnë në një situatë ku të rinjët mund të mësojnë nëpërmjet pajisjeve digjitale dhe me anë të leximit të librave. BONEVET angazhohet për edukimin dhe trajnimin e të rinjve, për të i'u mësuar atyre aftësitë e nevojshme akademike dhe emocionale, për t'i ndihmuar të punojnë në grupe, për të trajtuar dhe zgjidhur problemet, për të komunikuar dhe bashkëpunuar, dhe më e rëndësishmja të jenë mendimtarë kritikë.

BONEVET-i i parë u themelua në Gjakovë në vitin 2014, një qytet që u dëmtua rëndë gjatë luftës së fundit. Gjatë vitit 2017 më shumë se 500 fëmijë kanë ndjekur klasa të ndryshme dhe mbi 50 krijues, vajza dhe djem, kanë fituar aftësi teknike në projekte të ndryshme, ndërsa gjatë vitit 2018 kanë marrë pjesë 625 fëmijë dhe të rritur në klasat e BONEVET Gjakova.



Mësimi i bazuar në projekte i mundëson të rinjëve të fitojnë aftësi të menaxhimit, të përvetësojnë punën në grupe si dhe të krijojnë vetëbesim dhe këmbëngulje gjatë projektimit dhe realizimit të projekteve që duken të paarrtshme. Në vitin 2016, 6 adoleshentë, 3 vajza dhe 3 djem, kanë arritur të konvertojnë një automjet të karburantit në një automjet elektrik, një projekt i cili krijoi valë të mëdha motivimi për të gjithë fëmijët në Kosovë.

BONEVET ka pasur një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në komunitetin e Gjakovës dhe vazhdon t'i japë shpresë komunitetit që është lënë vetë pas luftës, sepse shumë njerëz të arsimuar dhe të aftë u larguan nga aty për të kërkuar punë diku tjetër.

Duke ndjekur shembullin e Gjakovës u krijua një tjetër hapësirë krijuese "Maker-Kids / Make-Space" BONEVET në Prishtinë në vitin 2017. Në vitin 2018 kanë marrë pjesë 599 fëmijë në klasa të robotikës, shkencës, matematikës, shahut, artit dhe gjuhës si dhe trajnime profesionale për të rritur (CNC, 3D Dizajn, Elektronikë Kreative, Dizajn Grafik dhe gjuhë programuese). Në vitin 2019, më shumë se 1000 fëmijë ndjekin mësimet në BONEVET.

BONEVET gjithashtu është nderuar me zgjerimin e hapësirave, në dy mjedise të reja stimuluese për krijuesit e rinj. Në janar është themeluar BONEVET-i i tretë në Kosovë, Kaçanik. Me mbështetjen e BONEVET Prishtina, ata kanë bërë përpjekje të vazhdueshme në krijimin e këtij institucioni të ri. Kaçaniku është një komunë me një nivel shumë të lartë të papunësisë së të rinjve. Me mjedisin e ri stimulues po fillojmë një udhëtim për të ndërtuar një bazë të fortë të ndërmarrësve të rinj, të cilët do të krijojnë kompani të reja të suksesshme lokale dhe do të krijojnë vende të reja pune në qytetin e Kaçanikut dhe rrethinë. Qëllimi është të krijojmë gjeneratë të udhëheqësve të rinj dhe kjo nuk është e gjitha. BONEVET Tirana është themeluar me mbështetjen e BONEVET Prishtina.

Përveç kësaj, në shkurt të vitit 2018, BONEVET ka nisur projektin Kosova Makers League (KML). KML është gara e parë robotike e hapur për të gjitha shkollat fillore dhe shkollat e mesme në Kosovë.



Sezoni i parë i garës së robotikës ka përfunduar me sukses të jashtëzakonshëm. Përgjatë një vit e gjysëm, më shumë se 700 të rinjë nga më shumë se 15 komuna të Kosovës janë bërë pjesë e kësaj gare.

Shkollat fituese do të prezantojnë Kosovën në Garën Regjionale të Robotikës në Zagreb dhe me shumë shpresë në Garën Robotike Botërore në Shanghai, Kinë.

*“Vizioni i BONEVET është të ndërtojnë një rrjet të qëndrueshëm të hapësirave mësimore dhe trajnuese, bazuar në modelin e BONEVET, në qendrat kryesore dhe vendet rurale në mbarë Kosovën. Ndërtimi i një gjenerate të re të zgjidhësve produktiv të problemeve, mendimtarëve kritikë dhe të rinjëve me shpirt ndërmarrës, do të përfaqësojë një bazë të fortë për zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë sonë”.*






Vajzen (8 vjet) e kemi regjistruar me pak hezitimin në klasën Lego Robotics me frike se mos, për shkak të moshës, po i humb interesimi në programim dhe inxhinieri. Por metodat moderne të mesimit, profesionalizmi i stafit dhe menyra e zhvillimit të klases na ka befasuar për të mirë.


Në një moshë të re fëmijet mesuan si të mendojnë logjikisht, të punojnë në ekip, të jenë kreativ, të ndërtojnë robot dhe ti programojnë ata të kryejnë veprime të ndryshme, duke marrë kështu një bazë shumë të mirë për të ardhmen.

Vajza menjëherë kerkoi të regjistrohet në klasën e ardhshme e cila u rekomandua nga stafi i Bonevet në baze të aftësive që ajo ka treguar gjatë klases Lego Robotics.

- Edmond Berani













**Sistemi koordinativ kartezi**

Sistemi koordinativ kartezi është një sistem i koordinatimit që përdor koordinatat kartezi (x, y) për të vendosur pozicionin e objektit në hapësirë. Ky sistem është i përdorur në shumë aplikime, siç janë robotika, imazhi dhe audioviziveli dhe në hapësirën 2D dhe 3D.

**YANI**  
org




**T E TRAJNIMEVE PROFESIONALE NË BO**  
**SHUMË MUNDËSI TË BËH**  
**E TREGUT TË PUNJ**



































## Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSIGNOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : O-71107041-01553-0-35-0

|   |                                |
|---|--------------------------------|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:                                       | 02-670/19                      |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:           | 26.12.2019 - 11:37             |
| Komuna / Opština / Municipality:  | Kamenicë / Kamenica / Kamenice |
| Zona kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastral Zone:                                       | KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE |
| Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Kamenicë / Kamenica / Kamenice |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastrarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>C/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Pëshkrim<br>Opis<br>Description                                  | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--|--|--|---------------------------|---|--|---|----------------------------------|
| O-71107041-01553-0-35-0  | NDËRTESE /<br>ZGRADA / BUILDING                | Shoqërore /<br>Društvena /<br>Socially           | U                         | 2459.49   | VENDIM - Kavendi Komunal i Kamenicës, Nr.9235, e dat.29.03.2019. | 13.12.2019  | 18.12.2019                       |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address       | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësi e adresës<br>Pojednostni adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|--|---|--|---|----------------------------------|
| LUMI / KAMENICA / REKA / LUMI / KAMENICA / REKA / LUMI / KAMENICA / REKA |   | B+P+I  |   | 18.12.2019                       |



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Driton Syllaj | O-71107041-01553-0-35-0 | Zyrtarë përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



A.3 NDĒRĒTESAT / ZGRADE / BUILDINGS

| Nuzari i ndĒrĒtesē<br>Broj zgrada<br>Building Number | Loji i ndĒrĒtesēs<br>Vrsta zgrade<br>Building Type | ShryfĒzāmi aktual i ndĒrĒtesēs<br>Trenutno koriscenje zgrade<br>Building Current Use | SipĒrfācija<br>Površina<br>Area<br>(m <sup>2</sup> ) | Katet<br>Spratovi<br>Floors | Loja e ndĒrĒtimit<br>Grādjevinska dozvola<br>Building permit                   | Viti i ndĒrĒtimit<br>Godina izgradnje<br>Construction Year | Cnini i kontraktuar<br>Ugovorena cena<br>Contract Price | Azhurnar<br>Azhurnano<br>Updated |
|--|--|--|--|-----------------------------|--|--|---|----------------------------------|
| O-71107041-01553-0-35-0                              | Kultura/Kultura/Culture                            | NdĒrĒtesat tjera kulturore/Ostale<br>kulturne zgrade/other culture<br>building       | 2459.49  | B+P+1                       | V E N D I M - Kuvendi<br>Komunal i Kamēnicēs,<br>Nr.9235, e<br>dat.29.03.2019. |  |   | 18.12.2019                       |

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Tē drejlat<br>Prava<br>Rights  | Emri<br>Ime<br>Name              | Nr. personal<br>Lici broj<br>ID. No. | Vendbaninai<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollisē e adresēs<br>Pojedrtinosi adrese<br>Address details | Pjesa e pronēs<br>Dio inovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description                                      | Azhurnar<br>Azhurnano<br>Updated |
|--|----------------------------------|--------------------------------------|---|---|---|--|--|----------------------------------|
| Pronēsā individualē (Njē<br>Pronarē) / Individualno<br>Vlasništvo (1 V1) / single<br>owner | P.SILKUVENDI KOMUNAL<br>KAMENICĒ | KCID1110190                          | KAMENICĒ /<br>KAMENICA /<br>KAMENICĒ /  |   |   | 1/1  | VENDIM - Kuvendi Komunal i<br>Kamēnicēs, Nr.9235, e<br>dat.29.03.2019. | 26.12.2019                       |

⊕ New mail

<<

▶ Favorites

Inbox 3

Sent Items

Drafts (3)

▶ Irfan Dermaku

Inbox 3

Drafts (3)

Sent Items

Deleted Items

Junk Email

Notes

▶ RSS Feeds

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo Republic of Kosovo  
Gjenera - Vlada - Government  
Ministria e Hapësirës dhe Planifikimit Hapësirorë - Ministry of Spatial Planning and Construction  
KOSOVA MINISTRI I HAPËSIRËS DHE PLANIFIKIMIT HAPËSIROR

Zyra Kadastrale Komunale KAMENICë  
Zona KadastraleKamenicë  
Prorant: P. SH Kuvendi Komunal  
Niveli i rregjisë kadastraleOBJEKT

Adresa dhe vendi kuqajurFidanishte  
Niveli i njësive kadastrale1561.0  
Shtabla e zvoçimit1:1200

Lista e koordinatave dhe kodit për origjinën e tyre

HYRJA 4.39m  
48.45m  
84.41m  
21.01m²  
98.52m  
401.81m²  
25.27m  
26.58m²  
14.80m²  
34.73m  
21.08m  
21.08m  
21.08m  
21.08m

ZYRE E PEPBASHKET  
DRE  
KORIDORI  
ZYRE  
DRETTORI  
SANITARI  
ANSHIVE  
KURILET

HAPSIRA E PERGJITHESHME 400 M<sup>2</sup>

Rrefer: Gjendje/Kompania  
M. Komenda  
Marrëkryeri  
Data e ri-aktimit

Approvimi  
Heshtkrahimi  
Data aprovimi





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Administratës Publike*  
*Ministarstvo Javne Administracije*  
*Ministry of Public Administration*

---

Departamenti për OJQ  
Departament za NVO  
Department for NGO

25/02/2020

Ref. 414 / 2020

**LETËRKONFIRMIM**

Me të cilin vërtetohet **Fondacioni BONEVET Kamenicë** është Organizatë Joqeveritare e regjistruar në Departamentin për OJQ, Ministria e Administratës Publike. Certifikata e Regjistrimit Nr. 5200497-7

Është vendosur në adresën: Shtëpia e Kulturës "Isa Kastrati", Rr. Skenderbeu , Kamenicë, Kamenicë

Përfaqësues i autorizuar është: Lekë Zherka, Koordinator

Njëkohësisht ka të drejtë për menaxhimin e llogarisë rrjedhëse bankare në emër të OJQsë.

Ju lutem mos hezitoni të kontaktoni në Departamentin për OJQ, nëse ju duhet të kërkoni informata tjera.

---

Verifikimin e këtij dokumenti, mund ta bëni në linkun - Verification of this document, you can do on the link -  
Verifikaciju ove potvrde, možete uveravati na linku:  
<http://ojq.rks-gov.net/KerkoOJQ.aspx>

REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
QENDRA PËR SHËRSIM TË QYTETARËVE  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 29301  
U. \_\_\_\_\_ Br. \_\_\_\_\_  
Nr. i faq. 3 Data: 19/09  
Dr. str. \_\_\_\_\_ Datum: \_\_\_\_\_  
KAMENICËJA 2019



FONDACIONI UNË E DU  
KOSOVËN

Kamenicë, 19 Shtator 2019

MARRËVESHJE PËR THEMELIMIN E  
"FONDACIONI BONEVET KAMENICË"

Mes partnerëve themelues

1. Fondacionit "Unë e Du Kosovën" me seli në Prishtinë, i përfaqësuar nga Vllaznim Xhiha, në tekstin vijues Fondacioni dhe
2. Komuna e Kamenicës të cilën e përfaqëson Kryetari I Komunës z. Qëndron Kastrati, në tekstin vijues: Komuna

Neni 1

Objekti I Marrëveshjes

Nënshkruesit e kësaj marrëveshje pajtohen të krijojnë "Fondacionin BONEVET Kamenicë" një mjedis mësimi jofitimprurës dhe joformal në Qendrën Kulturore Rinore Kamenica.

Neni 2

Qëllimi I Marrëveshjes

Palët synojnë që përmes kësaj Marrëveshjeje të krijojnë kushte për të rinjët dhe qytetarët e komunës që të trajnohen në profesione të ndryshme përmes njohurive teorike dhe praktike të teknologjisë moderne, të cilat janë burim potencial i ideve inovative për krijimin e biznesve të suksesshme.

Neni 3

Obligimet e palëve

3.1 Komuna është e obliguar që të plotësojë kushtet vijuese:

3.1.1 Të sigurojë hapësirat e nevojshme për punët e Fondacionit "Unë e Du Kosovën", në Qendrën Kulturore Rinore Kamenica dhe këto hapësira të punës t'ia dorëzojë BONEVET Kamenicë për shfrytëzim, pa kompensim material për një periudhë prej 10 gjerë në 15 vite.

3.1.2 Të renovojë hapësirën e objektit të Qendrës Kulturore Rinore Kamenica, duke i përshtatur ato për shfrytëzim nga BONEVET Kamenica sipas vizatimeve dhe propozimeve nga BONEVET Prishtina (shih aneksin e bashkangjitur).

3.1.3 Të bashkëpunojë me stafin menaxhues të BONEVET Kamenica për realizimin e programeve të cilat janë me interes për synimet zhvillimore të Komunës së Kamenicës.

3.1.5 Të mbulojë kostot operative për funksionim korrekt të BONEVET Kamenica (shih aneksin e bashkangjitur).

### **3.2 Fondacioni është i obliguar që të plotësoj kushtet vijuese:**

3.2.1 Të përcaktojë listat e nevojshme të mobiljeve dhe pajisjeve, si dhe të sigurojë vizatimet e nën-hapësirave për BONEVET Kamenica.

3.2.2. Të asistojë dhe mbështesë në mbledjen e fondeve për mobiljet dhe pajisjet nga organizatat ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë, për nevojat e klasave që do të organizohen në BONEVET Kamenica.

3.2.3. Të asistojë në procesin e punësimit të stafit për projektin BONEVET Kamenica.

### **Neni 4**

#### **Përfituesit**

Nga projekti "BONEVET" do të përfitojnë të rinjtë dhe qytetarët e Komunës së Kamenicës në procesin e të mësuarit të aftësive teknike, aftësive të buta dhe sipërmarrjes që do t'i ndihmojnë ata të shndërrojnë idetë e tyre në produkte dhe shërbime dhe kështu të krijojnë vende të reja pune.

### **Neni 5**

Me këtë marrëveshje, nënshkruesit konfirmojnë vullnetin e lirë të bashkëpunimit, i cili ka për qëllim interesin publik të të rinjve dhe qytetarëve të tjerë të interesuar të Komunës së Kamenicës.

### **Neni 6**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet me pajtimin e të dy palëve nënshkruese, ndërsa konfliktet eventuale lidhur me objektin, qëllimin apo obligimet e palëve të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve nënshkruese.

Neni 7

Kjo Marrëveshje është përpiluar në 6 kopje identike dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën kur nënshkruhet nga personat e autorizuar.

Neni 8

Me këtë Marrëveshje, palët bien konform me të gjitha nenet e përshkruara më lartë në këtë dokument.

Palët

Fondacioni "Unë e du Kosovën"  
  
Vlazonim Xhiha, Bashkëthemelues  


Komuna e Kamenicës  
  
Qëndron Kastrati, Kryetar  




**BONEVET™**

*KONCEPTI për Kamenicën*

## Cka është BONEVET?

*BONEVET është një mjedis mësimi ku fëmijët inkurajohen të zbulojnë talentet dhe aftësitë e tyre si dhe t'i zhvillojnë ato me pasion dhe dashuri.*

Është një mjedis stimulues me mision për të krijuar mundësi që të rinjtë të zhvillojnë kureshtjen, imagjinatën dhe krijimtarinë e tyre me anë të lojërave dhe teknologjisë. Nëpërmjet qasjes së të mësuarit Bëje vetë (DIY), ne dëshirojmë që t'i rrisim të rinjtë ashtu që të arrijnë të jenë drejtues të komunitetit të krijuesve që kanë pasion të bëjnë gjëra dhe që duan ta ndajnë atë me të tjerët. Për të angazhuar dhe stimuluar lagjen, shkollën, qytetin ose rajonin e tyre. Ky komunitet prodhues do të nxisë sipërmarrjen dhe rritjen ekonomike.

BONEVET është një hapësirë e pajisur me stacione të kompjuterëve, mjete dhe makina si printera 3D, CNC, laborator elektronik / robotikë dhe pajisje për punëtori. Ka një hapësirë unike të të mësuarit për fëmijë (mosha 6-17 vjeç) me pajisje krijuese si LITTLEBITS, ARDUINO dhe RASPBERRY PI. Është një vend ku të rinjtë pasionantë i kthejnë idetë e tyre në produkte të bëra vetën, kështu duke u lidhur me prodhuesit e tjerë të komunitetit për të bërë prototipe dhe produkte edhe më të avancuara. BONEVET është fillimi i një lëvizjeje krijuese në të gjithë Kosovën.

*Motoja jonë është "nëse mund ta imagjinosh, mund ta krijosh"*

Ne rekomandojmë që BONEVET të konstituohet si një fondacion jofitimprurës.

## Cili është vizioni?

Sektori privat i Kosovës është i vogël dhe i dobët, por në rritje. Sidoqoftë, ekziston një kërkesë për inxhinierë, teknikë dhe punëtorë të kualifikuar manual. Kjo kërkesë pritët të rritet me kompanitë e reja që po themelohen në të gjitha fushat industriale.

Mungesa e personelit të kualifikuar është një nga sfidat më të mëdha në Kosovë. Kjo kryesisht për shkak të sistemit të dobët arsimor të Kosovës, që nga njëra anë përqendrohet shumë në njohuritë teorike, shpesh shumë të vjetërsuara. Përvoja praktike, e cila ka të bëjë me përdorimin e teknologjive më të reja të , kryesisht është lënë pas dore. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i njerëzve të kualifikuar kanë zgjedhur të kërkojnë punë jashtë vendit.

*Pasi BONEVET të rritet në një masë kritike, do të arrijë të bëhet burim i gjeneratave të reja me të rinjtë të përgatitur teknikisht për AFP dhe arsimim të lartë, një pjesë e të cilëve do të gjenerojnë ide të reja biznesi, të cilat do të shndërrohen në kompani të suksesshme të së ardhmes duke krijuar kështu vende pune për të rinjtë e papunë.*

Qëllimi ynë është të ndërtojmë një rrjet të qendrave BONEVET në tërë Kosovën. Pas BONEVET Gjakova, BONEVET Prishtina dhe BONEVET Kaçanik, përfaqësuesit e komunës së Kamenicës kanë shprehur dëshirën e tyre për themelimin e BONEVET Kamenica. Që nga nëntori i vitit 2014 ne kemi këshilluar të rinjtë të mësojnë aftësi praktike, të eksperimentojnë me njohuritë e tyre, të prototipojnë idetë e tyre dhe t'i hedhin

në treg, si dhe të ndajnë burimet dhe të bashkëpunojnë me industrinë. Qëllimi ishte të promovohet një qasje "praktike" ndaj aftësive të të mësuarit duke ofruar një mjedis fizik të pajisur me teknologjinë më të sofistikuar.

Pas pesë vitesh përvojë, BONEVET ka dëshmuar të jetë një mjedis ideal për fëmijët për:

- mësim me lojëra dhe teknologji,
- të qenë të lirë të bëjnë pyetje dhe ta bëjnë zërin e tyre të dëgjohet,
- stimuloni kuriozitetin, imagjinatën dhe krijimtarinë,
- zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe hartojnë lojërat e tyre,
- zgjerojnë aftësitë e tyre teknike në kodim, dizajnim, prototipim dhe krijim,
- të mësojnë të pëlqejnë matematikën, shkencën dhe artet,
- të zbulojnë talentet dhe aftësitë e tyre dhe t'i zhvillojnë ato me pasion dhe dashuri,
- të zhvillojnë një mentalitet në rritje, i cili do t'i inkurajojë ata të arrijnë qëllimet përmes punës së palodhur
- të zhvillojnë aftësi për të punuar në ekip,
- fitoni aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe aftësi të të menduarit kritik dhe zhvilloni vetëbesim
- të fitojnë aftësi për sipërmarrje, përmes mësimit të bazuar në projekt.

### Vendndodhja e BONEVET Kamenica

Vendndodhja fizike e BONEVET Kamenica është brenda Qendrës Kulturore Rinore Kamenica. Sipërfaqja e hapësirës në mënyrë ideale duhet të jetë 250-370 m<sup>2</sup> dhe duhet të jetë një "hapësirë e hapur", me panele që ndan nën-hapësirat, të ngjashme me hapësirën në BONEVET Prishtinë, ku komunikimi midis studentëve dhe stafit është i lehtë.

1. Stafit dhe administrata: hapësira prej 60 m<sup>2</sup>
2. MakerKids: hapësirë prej 40 m<sup>2</sup> për fëmijë (6-13 vjeç) x 2
3. Klasa Profesionale CAD-CAM, mekanikë dhe elektronikë: hapësirë prej 110 m<sup>2</sup> (14-25 + vjet)
4. Mësimi dhe bashkëpunimi i bazuar në projekt: hapësira 50 m<sup>2</sup>
5. Stoku i materialit: hapësira 25 m<sup>2</sup>
6. Nëse ka hapësirë shtesë në dispozicion, mund të akomodojmë një bibliotekë: hapësirë 40 m<sup>2</sup>

### Partnerët Themelues

BONEVET Kamenica do të themelohet nga Komuna e Kamenicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Qendron Kastrati dhe nga Fondacioni "UNE E DU KOSOVEN" i përfaqësuar nga Kryetari Vllaznim Xhiha. Këto dy organizata do të jenë përgjegjëse për themelimin e Fondacionit të ri "BONEVET Kamenica". Partnerët themelues do të përcaktojnë anëtarët e bordit si dhe drejtorin menaxhues të BONEVET Kamenica.



## Plani dhe Koha

1. Themelimi dhe regjistrimi i BONEVET Kamenica. Afati: Tetor 2019.
2. Përcaktimi i anëtarëve të Bordit. Afati: Tetor 2019.
3. Planimetria e hapësirës së BONEVET Kamenicës të dergohen për BONEVET Prishtina (Lekë Zherka) në mënyrë që të përcaktohet ndarja e hapësirave. Afati 20 qusht 2019.
4. Rekrutimi i Drejtorit Menaxhues të BONEVET Kamenica. Afati: Dhjetor 2019.
5. Rekrutimi i Zyrtarit Teknik të BONEVET Kamenica. Afati: Mars 2019.
6. Rekrutimi i administratorit të BONEVET Kamenica. Afati: Mars 2019.
7. Rekrutimi i 3 mentorëve të parë për klasa. Afati: Mars 2019.
8. Komuna e Kamenicës do të kryejë renovimin sipas udhëzimeve të BONEVET Prishtina. Afati: Mars 2020.
9. Prokurimi dhe dërgimi i pajisjeve për zyra dhe klasa. Afati: Mars 2020.
10. Trajnimi i stafit dhe mentorëve do të organizohet nga BONEVET Prishtina. Afati: Prill 2020.
11. Klasat e para pilotë për fëmijë. Afati: maj-qershor 2020.
12. Kampet verore. Afati: Korrik-Gusht 2020.
13. Klasat e para të rregullta. Afati: Shtator-Tetor 2020.

BONEVET Prishtina do të përcaktojë listat e nevojshme të mobiljeve dhe pajisjeve, si dhe do të sigurojë vizatimet e nën-hapësirave për BONEVET Kamenica.

BONEVET Prishtina do të asistojë dhe mbështesë në mbledhjen e fondeve për mobiljet dhe pajisjet nga organizatat ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë, për nevojat e klasave që do të ekzekutohen në BONEVET Kamenica. Dokumentet e nevojshme do të përgatiten për të aplikuar për donacione.

Burimet financiare për mbulimin e kostove operative për funksionimin korrekt të BONEVET Kamenica do të sigurohen nga Komuna e Kamenicës dhe të ardhurat nga klasat dhe nga donacionet e jashtme të mundshme.

## Bordi i drejtorëve dhe stafi i BONEVET Kamenica

BONEVET fillimisht do të drejtohet nga Bordi i Drejtorëve (3 persona) i cili do të sigurojë që BONEVET është i ndërtuar, mandatar dhe menaxhuar si duhet. Bordi do të ketë një funksion mbikëqyrjeje dhe do të mbledh e sigurojë të gjitha fondet e nevojshme për ndërtimin, pajisjen dhe funksionimin e organizatës. Anëtarët e Bordit do të emërohen nga Partnerët Themelues.

Bordi do të angazhojë Drejtorin Menaxhues jo më vonë se në dhjetor 2019.

Drejtori Menaxhues është përgjegjës për planifikimin dhe funksionimin korrekt të BONEVET. Fillimisht ai do të koordinojë realizimin e ndërtimit, pajisjes dhe vënies në punë të BONEVET. Pas inagurimit, ai do të jetë menaxher operacional dhe do të menaxhojë burimet, stafin e brendshëm, planifikon, organizojë dhe zbatojë trajnimet (teori dhe praktikë), do të sigurohet që ekziston një organizim i mirëfillt që është në përputhje me rregullat e rrepta të sigurisë.



Drejtori Menaxhues do të emërojë dy anëtarë të rinj të stafit Administratorin dhe Zyrtarin Teknik dhe dy mentorët e jashtëm deri në Mars 2020.

### Kurset e trajnimit dhe mentorët në BONEVET

Para se fëmijët dhe studentët të kenë të drejtë të ndjekin kurset në BONEVET Kamenica, të gjithë duhet të kalojnë një periudhë fillestare të trajnimit, ku do të mësojnë mbi rregullat e sigurisë dhe rregullat e tjera të organizatës. Për më tepër, ne do të ofrojmë kurse në kontinuitet për të zhvilluar aftësitë si programim, printim 3D, CNC, elektronikë, robotikë, etj. Kurset do të evulojnë në hap me teknologjitë e reja. Programi i detajuar dhe lloji i kurseve do të shpallen para inaugurimit. Pas kurseve fillestare, krijuesit më pas mund të punojnë në projektet e tyre individuale dhe të realizojnë ëndrrat e tyre.

Për të drejtuar kurset siç duhet, ne duhet të angazhojmë mentorë profesionistë që janë krijues dhe mësues të pasionuar dhe që dinë t'i udhëzojnë fëmijët / studentët në dëshirën e tyre për të mësuar duke krijuar. Mentorët do të zgjidhen nga Drejtori Menaxhues dhe stafi i BONEVET Kamenica.

### Financat BONEVET Kamenica

#### Hapësira fizike

Hapësirat fizike të punës dhe hapësirat e tjera shtesë për BONEVET do të vendosen në një ndërtesë tashmë ekzistuese, e cila do të rinovohet në përputhje me standardet e sigurisë të nevojshme për BONEVET. Rekomandojmë një hapësirë të madhe dhe të hapur prej 250-370m<sup>2</sup>.

#### Mobilje dhe pajisje për trajnime, laboratorë dhe hapësirë për zyra:

Kostoja minimale e vlerësuar për pajisjet për BONEVET Kamenica do të jetë si më poshtë:

|  |                                 |
|--|---------------------------------|
| 1) Fëmijët krijues për 7-17 vjet: LITTLEBITS, ARDUINO, m-BOT,... (1 set) | 25'000 EUR.-                    |
| 2) Mobilje (tavolina, karrige, rafte dhe të ngjashme)                    | 10'000 EUR.-                    |
| 3) Pajisjet e zyrës  | 8'000 EUR.-                     |
| 4) Pajisje kompjuterike CAD-CAM  | 15'000 EUR.-                    |
| 5) Laboratori i Elektronikës   | 22'000 EUR.-                    |
| 6) Pajisjet për shtypje 3D   | 10'000 EUR.-                    |
| 7) Punëtori Mekanike   | 20'000 EUR.-                    |
|  | <u>SUB-TOTALI 110'000 EUR.-</u> |
| 8) Punëtori për studentët MAKERKIDS (7-17 vjet)                          | 12'000 EUR.-                    |
| 9) Punëtori për studentë profesionistë (13-30 vjet)                      | 23'000 EUR.-                    |
|  | <u>SUB-TOTALI 35'000 EUR.-</u>  |
| Kostoja totale për investime në pajisje dhe punëtori                     | <u>TOTALI 145'000 EUR.-</u>     |

Shënim: Ky investim do të sigurohet nga organizatat ndërkombëtare: GIZ-Gjermani, SDC-Zvicër, USAID, etj.

### Kostot e funksionimit (Buxheti vjetor)

#### Kostoja e funksionimit:

Kostot operacionale bëhen duke supozuar figurat e mëposhtme:

|            |   |                               |
|------------|---|-------------------------------|
| Viti 2020: | 12 kurse (10 për moshën 6-17 dhe 2 për 18+), me 8 studentë      | 96 studentë                   |
|            | 8 kampe verore me 10 fëmijë / kamp                              | 80 studentë                   |
|            |   | <u>Gjithsej: 176 studentë</u> |
| Viti 2021: | 32 kurse (24 për moshën 6-17 vjeç dhe 8 për 18+), me 8 studentë | 256 studentë                  |
|            | 8 kampe verore me 14 fëmijë / kamp                              | 112 studentë                  |
|            |   | <u>Gjithsej: 368 studentë</u> |
| Viti 2022: | 48 kurse (38 për moshën 6-17 dhe 10 për 18+), me 8 studentë     | 384 studentë                  |
|            | 8 kampe verore me 16 fëmijë / kamp                              | 128 studentë                  |
|            |   | <u>Gjithsej: 512 studentë</u> |

Mentorët marrin një pagë mesatare prej 250 EUR. - për një kurs 8 javë (2x2.5 orë në javë).

Për mentorët më profesionistë kostoja mund të shkojë deri në 500 EUR.-

#### Punonjësit:

Viti 2020: 3 punonjës: MD 650 EUR, Zyrtar Teknik 500 EUR, Administrator 400 EUR,

Viti 2021: 3 punonjës: MD 750 EUR, Zyrtar teknik 500 EUR, Administrator 400 EUR,

Viti 2022: 3 punonjës: MD 900 EUR, Zyrtar teknik 650 EUR, Administrator 500 EUR

### Kostot Operacionale: Viti I parë 2020

|   |                   |
|---|-------------------|
| - Stafi (MD: 12x650, TO: 8x500, Admin. 8x400) | EUR 15'000        |
| - Mentorët për 12 kurse (10x250, 2x500)       | EUR 3'500         |
| - Shërbimet komunale (energji elektrike, ujë) | EUR 4'000         |
| - Pastrimi dhe shpenzimet e tjera             | EUR 1'200         |
| - Materialet për zyrë dhe printim             | EUR 700           |
| - Materialet për punëtori                     | EUR 800           |
| - Marëdhëniet me publikun                     | EUR 1'500         |
| - Mirëmbajtja dhe shpenzimet e tjera          | EUR 1'500         |
|   | <b>TOTAL</b>      |
|   | <b>EUR 28'200</b> |

### Të ardhurat nga Tarifat e Trajnimeve dhe Tarifat e Anëtarësimit: Viti i parë 2020

|  |                           |                     |
|--|---------------------------|---------------------|
| Tarifa e Anëtarësimit (vjetor): EUR 120. - | Supozim 10 anëtarë (50%)  | EUR 600.-           |
| Tarifa e Trajnimit (fëmijë): EUR 60. -     | Supozim 80 fëmijë (80%)   | EUR 3'840.-         |
| Tarifa e Trajnimit (të rritur): EUR 160. - | Supozim 16 studentë (80%) | EUR 2'304.-         |
| Kampet Verore (fëmijë): EUR 60. -          | Supozim 80 fëmijë (80%)   | EUR 3'840.-         |
|  | <b>TOTAL</b>              | <b>EUR 10'584.-</b> |

*SHËNIM: Dy klasët e para pilot në vitin 2020 janë pa pagesë.*

**Mbulimi OPEX VITI I I-rë 2020: Fondacioni UEDK: € 5,000 Komuna: € 12,616**



**Kostot Operacionale: Viti I dytë 2021**

|  |       |            |
|--|-------|------------|
| - Stafi (3 të punësuar)                                    |       | EUR 19'800 |
| - Mentorët për 24 trajnime (250 EUR dhe 500 EUR /trajnimi) |       | EUR 9'600  |
| - Shërbimet Komunale (energji elektrike, ujë, ngrohje)     |       | EUR 6'000  |
| - Pastrimi dhe shpenzimet e tjera                          |       | EUR 2'000  |
| - Materialet për zyrë dhe printim                          |       | EUR 2'000  |
| - Materialet për punëtori                                  |       | EUR 2'000  |
| - Marëdhëniet me publikun                                  |       | EUR 2'000  |
| - Mirëmbajtja dhe shpenzimet e tjera                       |       | EUR 2'000  |
|  | TOTAL | EUR 45'400 |

**Të ardhurat nga Tarifat e Trainimeve dhe Tarifat e Anëtarësimit: Viti I dytë 2021**

|  |         |                   |            |
|--|---------|-------------------|------------|
| Tarifa e Anëtarësimit (vjetor): EUR 120. - | Supozim | 20 anëtarë (70%)  | EUR 1'680  |
| Tarifa e Trajnimit (fëmijë): EUR 60. -     | Supozim | 192 fëmijë (90%)  | EUR 10'368 |
| Tarifa e Trajnimit (të rritur): EUR 160. - | Supozim | 64 studentë (80%) | EUR 8'192  |
| Kampet Verore (fëmijë): EUR 60. -          | Supozim | 112 fëmijë (100%) | EUR 6'720  |
|  | TOTAL   |                   | EUR 26'960 |

**Mbulimi OPEX VITI I II – të 2021 : Fondacioni UEDK: € 5000 .-, Komuna e Kamenicës 13'440**

**Operational Costs: Third Year 2022**

|  |       |            |
|--|-------|------------|
| - Stafi (3 të punësuar)                                    |       | EUR 24'600 |
| - Mentorët për 48 trajnime (250 EUR dhe 500 EUR /trajnimi) |       | EUR 14'400 |
| - Shërbimet Komunale (energji elektrike, ujë, ngrohje)     |       | EUR 8'000  |
| - Pastrimi dhe shpenzimet e tjera                          |       | EUR 3'000  |
| - Materialet për zyrë dhe printim                          |       | EUR 3'000  |
| - Materialet për punëtori                                  |       | EUR 5'000  |
| - Marëdhëniet me publikun                                  |       | EUR 3'000  |
| - Mirëmbajtja dhe shpenzimet e tjera                       |       | EUR 5'000  |
|  | TOTAL | EUR 66'000 |

**Të ardhurat nga Tarifat e Trainimeve dhe Tarifat e Anëtarësimit: Viti I tretë 2022**

|  |         |                   |            |
|--|---------|-------------------|------------|
| Tarifa e Anëtarësimit (vjetor): EUR 120. - | Supozim | 50 anëtarë (70%)  | EUR 4'200  |
| Tarifa e Trajnimit (fëmijë): EUR 60. -     | Supozim | 304 fëmijë (90%)  | EUR 16'416 |
| Tarifa e Trajnimit (të rritur): EUR 160. - | Supozim | 80 studentë (80%) | EUR 10'240 |
| Kampet Verore (fëmijë): EUR 60. -          | Supozim | 128 fëmijë (100%) | EUR 7'680  |
|  | TOTAL   |                   | EUR 38'536 |

**Mbulimi OPEX VITI I III - të 2022: Fondacioni UEDK: € 5'000.-, Komuna e Kamenicës € 22'464**

SHENIM: Kurset më të sofistikuara si modelimi 3D, CNC, kurset e elektronikës mund të jenë të paraqitura si Punëtori dhe pagesa e mentorëve mund të kërkohet nga donacionet për të mbuluar një pjesë të kostove operacionale.

### Energjia elektrike

Në parim, të gjitha pajisjet përdorin energji njëfazore. Ne rekomandojmë që në dhomën Mekanike dhe në Laboratorin Elektronik të pajisen me energji trefazore dhe të instalohet një sistem ventilimi.

Laboratori Mekanik: a) energji njëfazore: 8 kW  
b) energji trefazore: max. 5 kW (për kompresorë dhe paisje të ngjajshme)

Laboratori Elektronik: a) energji njëfazore: 12 kW

Laboratori CAD-CAM: a) energji njëfazore: 8 kW

Të gjitha hapësirat e tjera kanë nevojë për energji standarde për kompjuterë dhe printerë në të gjitha hapësirat, përfshirë korridoret.

---

Përpiluar nga:

*Vllaznim Xhiha, Kryetar I BONEVET*

*Lekë Zherka, Drejtor Menaxhues BONEVET Prishtinë*